



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 166, Datë 28.06.2022

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË  
PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA TË RINOVUESHME NGA DIELLI ME FUQI  
TË INSTALUAR DERI 2 MW PËR VITIN 2022**

Në mbështetje të nenit 10 pika 2, 16 dhe 19 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 10, pika 3 të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 369, datë 26.04.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”; VKM-së nr. 580, datë 28.08.2019 “Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019–2020”, i ndryshuar dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedruat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s; në mbledhjen e tij të datës 28.06.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 935/8 prot., datë 24.06.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2 MW për vitin 2022”,

**Konstatohet se:**

- ERE ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në bazë të nenit 10, pika 3 të ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe VKM-së nr. 369, datë 26.04.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 27, datë 14.02.2022, vendosi fillimin e procedurës “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2022”.

- ERE me shkresen nr.342 prot., datë 02.03.2022, ka njoftuar Ministrine e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetin e Konkurrencës (AK), Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (MSHMS), Agjensinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (ASHZHI), si dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL), lidhur me fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2022.
- MIE me anë të shkresës nr. 2842 prot., datë 01.04.2022 është shprehur se, bazuar në VKM-në nr. 822, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, e ndryshuar, për vitin 2022 ka miratuar ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet 2 MW për 5 subjekte.
- Gjithashtu, me anë të shkresë së sipërcituar MIE ka përcjellë për referencë Planet e Biznesit të paraqitura nga subjektet mbajtëse të miratimit përfundimtar.
- VKM nr. 369, datë 26.04.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era” ka përcaktuar kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve, sipas llojit të teknologjisë së përdorur. Në themel të metodologjisë së miratuar me VKM-në e lartpërmendur është llogaritja e kostonë së prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme nëpërmjet formulës llogaritëse të LCOE-së (kosto e niveluar e energjisë elektrike).
- Çmimi i blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2MW, është një cmim mesatar dhe si i tillë, në vijim dhe të praktikave të viteve të mëparshme, të gjithë komponentët përlllogaritës të këtij çmimi janë të mesatarizuar.
- Për llogaritjen e LCOE janë marrë në konsideratë të dhëna mbi komponentët përbërës të nevojshëm, nga burimet si më poshtë vijon:
  - Planet e biznesit të shoqërive mbajtëse të miratimit përfundimtar, siç përcjellë nga MIE (Kosto e investimit, shpenzimet operative, degradimi vjetor i prodhimit, jetëgjatësia e inverterit);
  - VKM nr. 580, datë 28.08.2019 “Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019–2020”, i ndryshuar (kosto mesatare e ponderuar e kapitalit, periudha e mbështetjes dhe orët mesatare të punës);
  - Studimi i IEA (International Energy Agency- Renewables 2021 Analysis and forecast to 2026);
  - Studimi i MDPI – Një rishikim i degradimit të moduleve fotovoltaike për jetëgjatësinë (A Review of the Degradation of Photovoltaic Modules for Life Expectancy).
- Në zbatim të sa më sipër dhe nisur nga eksperiencia e krijuar për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet prodhuese fotovoltaike deri në 2MW

dhe eolike deri në 3MW në periudhat e mëparshme, është llogaritur çmimi i blerjes së energjisë të prodhuar nga impiantet fotovoltaike për vitin 2022, duke përdorur modelin e excel-it të hartuar nga AGORA në studimin e saj për Shqipërinë.

- Në kontratat respektive midis subjekteve mbajtëse të miratimit përfundimtar dhe MIE përcaktohet se vlerësimi i investimeve mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve, në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit për ndërtimin e parkut eolik, si dhe MIE bazuar në raportin përfundimtar të testimit dhe pas paraqitjes nga mbajtësit e miratimit përfundimtar të raportit të plotë të shpenzimeve për ndërtimit e veprës, lëshon Çertifikatën e pranimit të veprës sipas legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në 2 MW prej 97.21 Euro/MWh, për vitin 2022.
2. Çdo ndryshim në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga ERE.
3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**